



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Tepelenë, më 29.04.2026

Nr.5 Prot.

PROÇES – VERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

Procesverbal i Mbledhjes së Këshillit Bashkiak Tepelenë, i mbajtur sot, më:

Data: 29.04.2026


Ora: 11:00

Vendi: Pallati i Kulturës Tepelenë (kati i dytë)

Mbledhja e Këshillit Bashkiak Tepelenë u thirr nga Kryetari i Këshillit, në bazë të Nenit 53, pika 3, gërma a, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, si dhe "Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak", me këtë:

Rend Dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluara datë 30.03.2026.
3. **Projektvendim:** "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Mars 2026".
4. **Projektvendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Mars 2026".
5. **Projektvendim:** "Për miratimin nivelit të pagave të strukturës organizative të Bashkisë Tepelenë".
6. **Projektvendim:** "Për miratim të kërkesës, për heqje dore nga pasuria e paluajtshme me status juridik "Në përdorim të Bashkisë Tepelenë" me numër pasurie 3/1-A ZK3574 dhe numër rendor të pronës në listën e inventarit 1358 sipas VKM nr 6 datë 06.01.2011 "Për miratim të listës përfunimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi



ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë” fusha e përdorimit Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)”.

7. **Projektvendim:** "Për miratimin në parim të zhvillimit të agroturizmit në sistemet bujqësore dhe natyrore sipas shprehjeve të ineteresit në tokat e dhëna me qira nga Bashkia Tepelenë".
8. **Projektvendim:** “Për dhënie titull nderi”
9. **Projektvendim:** “Për emërtimin rruge në Njësinë Administrative Lopes”
10. Raportim nga Drejtoria e Zhvillimit Rural: Mbi kontrollin dhe zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në kontratat e qirasë “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”, si dhe për dhënien në përdorim të tokës bujqësore për kontratat e lidhura me afat të gjatë, së bashku me raportimin mbi gjendjen e tyre. Gjithashtu, paraqitet informacion mbi veprimtarinë në sektorin e bujqësisë, duke përfshirë: sistemimin dhe investimet në kanalet kulluese dhe vaditëse, gjendjen e tyre, asistencën teknike ndaj fermerëve, si dhe arritjet, sfidat dhe problematikat e hasura në këtë sektor.
11. Çështje të tjera.
12. Trajtimi i kërkesave të qytetarëve.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Arben Gumeni, drejton mbledhjen.

Ora e hapjes së mbledhjes: 11:00.

Këshilltarët pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes janë: Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Esmeralda Bishani, Ilir Haska, Dino Selimi, Marsela Balili dhe Miftar Meta.

Nga administrata e Bashkisë marrin pjesë: Julinda Karteri, Gëzim Shehu, Arta Shaha dhe Armand Sala.

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni, deklaron hapjen e mbledhjes dhe paraqet rendin e ditës.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës.

Vota PRO: 11 Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Esmeralda Bishani, Ilir Haska, Dino Selimi, Marsela Balili, Miftar Meta.

Vota kundër: Nuk ka Vota abstenim: Nuk ka

Pika e dytë e rendit të ditës: “Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, datë 30.03.2026”

Kryetari i Këshillit; Ka pyetje këshilltarëve në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar. Këshilltarët shprehin dakordësinë për përmbajtjen e procesverbalit.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Vota PRO: 11 Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Esmeralda Bishani, Ilir Haska, Dino Selimi, Marsela Balili, Miftar Meta

Vota kundër: Nuk ka Vota abstenim: Nuk ka

Pika e tretë e rendit të ditës: “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fondin 6% të fondit të kushtëzuar për muajin mars 2026”

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë,: Komisioni u mbledh dhe u njoh me materialin, situata është e njëjtë me muajin e kaluar. Ju ftoj ta miratojmë.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit të hapur për miratimin e projektvendimit.

Vota PRO: 11 Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Dino Selimi, Marsela Balili.

Vota kundër: Nuk ka Vota abstenim: Nuk ka

Pka e katërt e rendit të ditës: “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin mars 2026”

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë,: Komisioni u mbledh dhe u njoh me materialin. Ka një ndryshim nga muaji i kaluar, me pakësim të një familjeje në Njësinë Administrative Kurvelesh.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit të hapur për miratimin e këtij projektvendimi.

Vota PRO: 11 Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Dino Selimi, Marsela Balili.

Vota kundër: Nuk ka Vota abstenim: Nuk ka

Pika e pestë e rendit të ditës: “Për miratimin e nivelit të pagave të strukturës organizative të Bashkisë Tepelenë”

Fjalën e mori znj. Julinda Karteri, e cila paraqiti materialin përkatës (bashkëlidhur).

Jeni njohur me materialin sipas relacionit. Po ju paraqes arsyet e ketij niveli pagash. Ndryshimet e reja ligjore dhe vendimet e Keshillit te Ministrave jane nje kusht themelor per percaktimin e nivelit te ri te pagave. Kemi punuar si drejtori, ne bashkepunim edhe me Drejtorine e Finances, qe kjo rritje page te jetë ne raport me te ardhurat qe gjeneron njësia e qeverisjes vendore, me qellim realizimin e indeksit te pagës per punonjësit e aparatit. Është e rëndësishme te theksohet se referencat qe kemi percaktuar jane ne perputhje me ligjin dhe kategorizimi i nepunesve civilë është bërë sipas percaktimeve ligjore. Te gjitha lidhjet qe ju keni ne material mbeten te pandryshuara. Nuk ndryshon vlera e diplomës, e cila vazhdon te jetë sipas tabelës ekzistuese: master shkencor 14.000 lekë, master profesional 12.000 lekë dhe bachelor 10.000 lekë. Vendimmarrjet jane te ndara sipas strukturave: aparati administrativ me vete, drejtorite me vete dhe Policia Bashkiake me vete. Ne material mungon referenca per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi, pasi dokumenti është depozituar ne sekretari perpara publikimit ne faqen zyrtare te vendimit te Keshillit te Ministrave. Rritja per MZSH-ne është rreth 2.5%.

Struktura është miratuar me urdher te Kryetarit te Bashkise dhe është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër. Struktura përbëhet nga gjashtë drejtori, dymbëdhjetë pergjegjës sektori, Sekretari i Pergjithshëm dhe specialistë, pjesë e nepunesve civilë. Gjithashtu, është shtuar Drejtoria e Turizmit dhe Integrimit European.

Fjalën e mori z. Vladimir Bakiaj: Kjo shtesë page është per te gjitha kategorite? Sa është rritur paga bazë e punonjësve te thjeshtë?

Znj. Julinda Karteri ;Paga bazë është rritur me 5.000 lekë.

Z. Vladimir Bakiaj:Po shtesat?

Znj. Julinda Karteri:Nëse shikoni ne tabelën e DSHPublike jane percaktuar punonjësit e thjeshtë dhe profesionistët, dhe aty është bërë diferencimi. Diferenca më e madhe është per punonjësit e varrimit dhe te mbetjeve, per shkak te kushteve te rënda te punës, ndaj jane trajtuar ndryshe.

Z. Vladimir Bakiaj:Cili është ndryshimi ndërmjet administratës dhe punonjësve te thjeshtë?

Znj. Julinda Karteri; Kategorizimi i nepunesve civilë bëhet sipas kategorive 4/3 dhe 4/4. Specialisti qe ka mbi 10 vite pune nuk trajtohet më ne kategorinë 4/4, pasi kjo kategori aplikohet per ata qe jane punësuar rishtazi.

Z. Vladimir Bakiaj; Kur hyn ne fuqi?

Znj. Julinda Karteri: Nga 1 janari 2026.

Fjalën e mori z. Latif Kaçaj:Para tre muajsh, ne si Keshill kemi bërë nje ndryshim lidhur me shpërblimin e pagesës së Kryetarit te Keshillit Bashkiak, por na është thënë se nuk i takon ne bazë te ligjit.

Znj. Julinda Karteri:Masa e shpërblimit, sipas referencës ligjore, është 10% e pagës së Kryetarit te Bashkise. Sa i perket vendimit konkret, nuk kam dijeni pasi nuk kam qenë pjesë e tij.



Z. Vladimir Bakiaj: Diku është bazuar.

Z. Latif Kaçaj: Nga administrata na është thënë se nuk i takon.

Znj. Julinda Karteri: Kush e ka sjellë përgjigjen?

Kryetari i Këshillit: Është propozuar nga Latifi për masën e shpërblimit të Kryetarit të Këshillit.

Znj. Julinda Karteri: Referenca ligjore është 10% e pagës së Kryetarit të Bashkisë për Kryetarin e Këshillit, ndërsa 5% e pagës së Kryetarit të Bashkisë për kryetarët e fshatrave.

Kryetari i Këshillit: Rregullorja e Këshillit ka dalë nga ligji.

Znj. Julinda Karteri: Ligji është mbi rregulloren dhe rregullorja nuk ka fuqi përpara ligjit.

Kryetari i Këshillit: Atëherë e lëmë.

Julinda Karteri: Ligji është taksativ, ndërsa rregulloren mund ta interpretojmë në forma të ndryshme. Për sa i përket rregullores, do ta lexojmë me vëmendje dhe mund të kërkojmë edhe ndihmë për argumentim dhe interpretim. Në interpretimin tim, pjesa e rregullores ka të bëjë me të gjithë veprimtaria që ka Këshilli, për të cilën ju keni të drejtë të merrni shpërblimin që ju takon, lidhet me funksionet e Këshillit. Veprimtari të tjera, si pjesëmarrja në trajnime apo urdhra shërbimi, trajtohen veçmas dhe nuk kanë lidhje me shpërblimin. Shpërblimi i Kryetarit të Këshillit është i përcaktuar në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë.

Kryetari i Këshillit: Rregullorja është hartuar mbi bazën e ligjit nr. 139/2015 dhe ky nen përcakton se Këshilli vlerëson mundësinë e shpërblimit shtesë. Mbi këtë bazë është bërë edhe propozimi nga anëtarët e Këshillit.

Fjalën e mori z. Mjaftoni Zeraj: Kur kemi miratuar strukturën e Bashkisë, është thënë se do të ketë punonjës me kontratë, si mjekë apo inxhinierë.

Znj. Julinda Karteri: E kemi parashikuar. Ju keni miratuar numrin prej 240 punonjësish dhe 15 punonjës me kohë të pjesshme. Ne kemi sqaruar se këta do të jenë me kontrata të jashtme.

Fjalën e mori znj. Matilda Çela: Rritja e pagave do të ndikojë tek investimet?

Znj. Julinda Karteri: Rritja e pagave ka faturën e saj financiare, por ne do të përpiqemi që kjo rritje të mos cenojë buxhetin për investimet.

Znj. Matilda Çela: Sa është diferenca e pagës midis drejtorëve?

Znj. Julinda Karteri: Nuk ka diferencë.

Kryetari i Këshillit deklaroi kalimin në votim të projektvendimit.

Vota PRO: 11 Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Dino Selimi, Marsela Balili.

Vota kundër: Nuk ka Vota abstenim: Nuk ka

Projektvendim: “Për miratimin e kërkesës për heqje dore nga pasuria e paluajtshme me status juridik ‘Në përdorim të Bashkisë Tepelenë’, me numër pasurie 3/1-A, ZK 3574 dhe numër rendor të pronës në listën e inventarit 1358, sipas VKM nr. 6, datë 06.01.2011 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë’, në fushën e përdorimit: prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (tokë produktive).

Fjalën e mori z. Gëzim Shehu, i cili paraqiti relacionin bashkelidhur OSSH ka paraqitur kërkesën me nr. protokollit 341, datë 13.02.2026 dhe nr. 341/2, datë 24.03.2026, për vendimmarrje nga Këshilli Bashkiak Tepelenë lidhur me heqjen e së drejtës së përdorimit të Bashkisë Tepelenë për një pjesë të pasurisë nr. 3/1, ZK 3574, me qëllim vijimin e procedurës nga OSSH për kalimin në administrim të saj në funksion të nënstacionit elektrik 110/10 kV Tepelenë.

Bëhet fjalë për sipërfaqen me numër pasurie 3/1-A, prej 925 m², pjesë e pasurisë nr. 3/1, ZK 3574, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim lënien në dispozicion për vazhdimin e procedurës së kalimit në administrim të OSSH-së për funksionimin e nënstacionit elektrik 110/10 kV Tepelenë.”

Fjalën e mori z. Vladimir Bakiaj: Pasuria 3/1-A mos është e ndarë?

Z. Gëzim Shehu: Është pasuri shtetërore, e regjistruar në përdorim të Bashkisë Tepelenë, e pandarë.

Znj. Julinda Karteri: Kjo pronë është e certifikuar dhe kjo është siguria që ne kemi për pasuritë e paluajtshme. Ne e kemi të certifikuar dhe jemi të qartë për kërkesën që ka bërë OSSH-ja. ASHK-ja ka dhënë miratimin në parim për transferimin dhe nuk cenojmë asnjë pasuri të qytetarëve tanë. Në referencë të ligjit, ata kanë bërë kërkesën për ta marrë në pronësi.

Z. Vladimir Bakiaj: Tek basenet e Vjosës ku është bërë ndërtimi, a është pasuria 3/1-B?

Z. Gëzim Shehu u përgjigj: Jo, është më lart, në një tokë tjetër. Kjo sipërfaqe është e lirë.

Znj. Julinda Karteri : Zona ku po bëhet ndërtimi është pasuri shtetërore dhe nuk ka lidhje me këtë pasuri. Nuk është cenuar askush.

Z. Gëzim Shehu: Procedura që ka nisur OSSH-ja do të vazhdojë pranë ASHK-së dhe më pas deri në Këshillin e Ministrave për transferimin e pronës. Ne nuk bëjmë as kalim pronësie dhe as transferim prone; vetëm heqim dorë nga përdorimi i pronës, që ajo të mbetet në dispozicion të shtetit për vazhdimin e procedurave nga institucionet përkatëse.

Z. Vladimir Bakiaj: Të jemi të sigurt që nuk preken.

Kryetari i Këshillit deklaroi kalimin në votim të projektvendimit.

Vota PRO: 11 Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Dino Selimi, Marsela Balili.

Vota kundër: Nuk ka Vota abstenim: Nuk ka

Projektvendim: “Për miratimin në parim të zhvillimit të agroturizmit në sistemet bujqësore dhe natyrore sipas shprehjeve të interesit në tokat e dhëna me qira nga Bashkia Tepelenë.”

Z. Gëzim Shehu relatoi materialin (bashkëlidhur).

Fjalën e mori z. Vladimir Bakiaj: A ka ndonjë masë kufizimi për këto zhvillime?

Z. Gëzim Shehu: PPV-ja është miratuar nga Këshilli Bashkiak dhe Këshilli Kombëtar i Territorit, dhe këto zhvillime do të jenë në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor. Kufizimet do të jenë sipas përcaktimeve të PPvendor.

Z. Vladimir Bakiaj: Plani i Përgjithshëm Vendor ende nuk është hedhur.

Z. Gëzim Shehu: Kjo është procedurë që ndiqet nga ASHK-ja. Kemi dërguar shkresë zyrtare pranë ASHK-së qendrore dhe ende nuk kemi marrë përgjigje.

Znj. Julinda Karteri: Edhe pas shkresës së dërguar nuk është kthyer përgjigje. AZHT-ja ia përcjell ASHK-së qendrore dhe më pas shpërndahet pranë drejtorive vendore.

Kryetari i Këshillit deklaroi kalimin në votim të projektvendimit.

Vota PRO: 11 Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Dino Selimi, Marsela Balili.

Vota kundër: Nuk ka Vota abstenim: Nuk ka

Projektvendim: “Për dhënie titulli nderi”

Fjalën e mori znj. Arta Shaha, e cila paraqiti materialin; Pranë Bashkisë Tepelenë kanë ardhur kërkesa nga shoqata Laberia, dhe nga Njësia Administrative Qendër Tepelenë për dhënie titulli nderi për dy qytetarë, të cilët kanë dhënë kontribut në qytetin e Tepelenës. Materiali është propozuar nga Kryetari i Bashkisë Tepelenë dhe i është përcjellë Komisionit Këshillimor të Vlerësimit të Figurave dhe Titujve të Nderit. Materiali ju është vënë në dispozicion.

Kryetari i Këshillit: Komisioni ka diçka për të thënë?

Fjalën e mori znj. Mirela Varfi: Komisioni, pasi shqyrtoi materialin për dhënien e titullit të nderit për z. Sulejman Liçaj dhe z. Ardian Hana, propozon që çështja të kalojë për votim në Këshill. Si komision, kemi gjithashtu propozimin që për Ardian Hanën, i cili ra në krye të detyrës, ne si

Këshill Bashkiak t'i propozojmë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë dhënien e statusit 'Dëshmor i Atdheut'.

Kryetari i Këshillit: Nuk është Këshilli i Qarkut që e jep statusin 'Dëshmor i Atdheut'. Kemi ligj dhe rregullore që përcaktojnë kush propozon dhe procedurën që ndiqet. Ju nuk keni të drejtë ta propozoni drejtpërdrejt te Këshilli i Qarkut. procedura dhe çështja kalon në komision. Duhet parë ligji për të përcaktuar kush e ka të drejtën e propozimit.

Fjalën e mori z. Latif Kaçaj:Këshilli Bashkiak ka të drejtë t'ia propozojë Qarkut.

Kryetari i Këshillit:Do ta shikojmë ligjin, pasi ka procedurë dhe duhet të kalojë në komision. Sot do ta miratojmë për titullin 'Qytetar Nderi'."

Kryetari i Këshillit deklaroi kalimin në votim të projektvendimit.

Vota PRO: 11 Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Dino Selimi, Marsela Balili.

Vota kundër: Nuk ka Vota abstenim: Nuk ka

Projektvendim: "Për emërtimin e një rruge në Njësinë Administrative Lopës"

Fjalën e mori znj. Arta Shaha, e cila paraqiti materialin përkatës:Pranë Drejtorisë së Arsimit, Kulturës dhe Kujdesit Social është paraqitur shkresa me nr. prot. 754, datë 20.04.2026, nga Njësia Administrative Lopës, Tepelenë, me kërkesë për emërtimin e një rruge në Njësinë Administrative Lopës. Segmenti rrugor nga Sinanaj në Matohasanaj, me gjatësi 2.38 km, propozohet të marrë emrin 'Naim Muhaj'.

Naim Muhaj ka lindur në fshatin Matohasanaj të Tepelenës, në krahinën e Lopësit, ku kaloi vitet e fëmijërisë dhe kreu arsimin fillor. Pas përfundimit të studimeve të larta në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, u emërua në ishullin e Sazanit.Në fund të viteve 70 u emërua Komandant i Korpusit të Tiranës dhe më pas Komandant i Divizionit të Lushnjës.Në mesin e viteve '80, ai u dënua si 'sabotator' i ishullit të Sazanit, në një kohë kur për fortifikimin e ishullit kishte marrë vlerësime nga autoritetet më të larta të kohës.

Ai fitoi pafajësinë në vitet e para të demokracisë dhe u rikthye në Ministrinë e Mbrojtjes me gradën Kolonel. Përkushtimi dhe kontributet e tij kanë qenë të mëdha edhe në periudhën postkomuniste, në reformimin e ushtrisë për përmbushjen e misionit të saj.

Gjithashtu, ka dhënë kontribute të rëndësishme në krijimin e Shoqatës Atdhetare Sazani'dhe në organizimin dhe drejtimin e Shoqatës Aleanca e Ushtarakëve të Shqipërisë.

Naim Muhaj ka mbartur virtyte, vlera humane dhe kontribute të veçanta. Për kontributet e tij si kuadër i devotshëm, familjar shembullor dhe demokrat i vërtetë, është vlerësuar me titujt 'Qytetar Nderi' dhe 'Mirënjohja e Qytetit', respektivisht nga Bashkia Tepelenë dhe Bashkia

Vlorë. Nisur nga sa më sipër, kërkojmë miratimin e Këshillit Bashkiak për propozimin e bërë nga Njësia Administrative Lopës, Tepelenë.”

Kryetari i Këshillit; Ka pyetje? JO

Kryetari i Këshillit; kalojme në votim të projektvendimit

Vota PRO: 11 Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Dino Selimi, Marsela Balili.

Vota kundër: Nuk ka Vota abstenim: Nuk ka

Raportim nga Drejtoria e Zhvillimit Rural: Mbi kontrollin dhe zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në kontratat e qirasë “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”, si dhe për dhënien në përdorim të tokës bujqësore për kontratat e lidhura me afat të gjatë, së bashku me raportimin mbi gjendjen e tyre. Gjithashtu, paraqitet informacion mbi veprimtarinë në sektorin e bujqësisë, duke përfshirë sistemimin dhe investimet në kanalet kulluese dhe vaditëse, gjendjen e tyre, asistencën teknike ndaj fermerëve, si dhe arritjet, sfidat dhe problematikat e hasura në këtë sektor.

Z. Gëzim Shehu paraqet materialin përkatës (bashkëlidhur).

Nga kontrollet e kryera në terren, për kontratat e mëposhtme kanë filluar punimet përgatitore të tokës, mbjelljet apo përdorimi i tokës sipas qëllimit të kontratës dhe nuk janë konstatuar shkelje të kushteve të kontratës, sipas tabelës bashkëlidhur materialitër kontratat me afat të gjatë është bërë njoftimi për zgjidhjen e kontratës ose është lënë një afat shtesë prej një sezoni për mbjellje, si dhe afat 1-mujor për dorëzimin e vërtetimit për shlyerjen e detyrimeve, pasi nuk janë zbatuar kushtet e kontratës për qiramarrësit, sipas tabelës bashkëlidhur. Për disa kontrata me afat të gjatë është bërë zgjidhja e kontratës, pasi nuk janë zbatuar detyrimet kontraktuale, sipas listës përkatëse. Për sa më sipër, ka filluar kontrolli i radhës në muajin prill 2026 për zbatimin e kontratave, duke qenë se përkon me përfundimin e sezonit të mbjelljeve. Nga tetori 2025 deri më 20.04.2026 kemi pasur auditim nga KLSH, si dhe pas marrjes së rekomandimeve dhe rakordimit me Zyrën e Tatim-Taksave për pagesat e qirasë, do të vijojmë në muajt maj-qershor me njoftimet për zgjidhjen e kontratave për subjektet që nuk kanë respektuar kushtet e tyre.

Do të bëhet gjithashtu njoftimi i subjekteve qiramarrëse për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, për subjektet që rezultojnë debitorë për pagesën e vitit të fundit apo kamatëvonesave. Në rast të mosshlyerjes brenda afatit të përcaktuar, do të nisën procedurat për zgjidhjen e kontratës së qirasë.

Trajtimi i kërkesave të qytetarëve:

Kryetari i keshillit; Është paraqitur kërkesa nga z. Selam Shehu, banor i fshatit Nivicë, Njësia Administrative Kurvelesh, i cili kërkon rrugë kalimi për në banesën e tij (bashkëlidhur kërkesa).

Kjo kërkesë i delegohet zyrës përkatëse në Bashki për shqyrtim.

Është paraqitur kërkesa nga z. Luman Asllani, banor i fshatit Dhemblan, Njësia Administrative Lopës, i cili kërkon një sipërfaqe toke rreth territorit të banesës së tij prej 200 m².
Kjo kërkesë i delegohet zyrës përkatëse në Bashki për shqyrtim.

Është paraqitur kërkesa nga z. Muhamet Xhebro, banor i fshatit Valiçot, Njësia Administrative Qendër, i cili kërkon hapje rruge (bashkëlidhur kërkesa).
Kjo kërkesë i delegohet zyrës përkatëse në Bashki për shqyrtim.

Është paraqitur kërkesa nga z. Enea Mici, banor i qytetit Tepelenë, i cili kërkon ndihmë financiare për dëmin e shkaktuar nga zjarri që ka përfshirë territorin ku ndodhen kosheret e bletëve në fshatin Kodër, Njësia Administrative Qendër (bashkëlidhur kërkesa).
Kjo kërkesë i delegohet zyrës përkatëse në Bashki për shqyrtim.

Është paraqitur kërkesa nga z. Osman Culli, i cili kërkon kalimin në pronësi të katër parcelave në fshatin Lekdush.
Kjo kërkesë i delegohet zyrës përkatëse në Bashki për shqyrtim.

Është paraqitur kërkesa nga z. Hysen Ismaili, banor i qytetit Tepelenë, i cili kërkon ndihmë financiare për shkak të vështirësive ekonomike dhe papunësisë.
Kjo kërkesë i delegohet zyrës përkatëse në Bashki për shqyrtim.

Është paraqitur kërkesë nga Organizata e Dëshmorëve të Atdheut, Dega Tepelenë, për vendosjen e bustit të Dëshmorit të Atdheut Dule Dalan Myftaraj.
Kjo kërkesë i delegohet zyrës përkatëse në Bashki për shqyrtim.

Mbyllet mbledhja e këshillit ora 12.00

SEKRETARE E KËSHILLIT

Valbona ÇELA



KRYETAR I KËSHILLIT

Arben GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCA E KËSHILLTARËVE
MBLEDHJA E KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË
Datë: 29.04.2026

Në mbledhjen e zhvilluar më datë 29.04.2026 morën pjesë këshilltarët si më poshtë:

Nr	Emër	Mbiemër	Neneshkrimi
1	ARBEN	GUMENI	
2	MATILDA	ÇELA	
3	DINO	DELIMI	
4	MIRELA	VARFI	
5	MJAFTONI	ZERAJ	
6	ESMERALDA	BISHANI	
	BESNIK	MAÇA	
8	LATIF	KAÇAJ	
9	MIFTAR	META	
10	ILIR	HASKA	
11	MARSELA	BALILI	
12	MARIOS	JORGO	
13	DITAR	HODAJ	
14	VLADIMIR	BAKIAJ	
15	VLADIMIR	GJONÇA	